

Bullgaria: Manastiri Novosellski në një video reklamuese të Ministrisë së Turizmit



Bashkë me Shoqatën e Guidave Bullgarë, Ministria e Turizmit përgatiti një seri prej videove reklamuese, të cilat prezantojnë skajet shumë pak të njohura të Bullgarisë. Shikoni filmin 2 minutash, kushtuar manastirit të bukur Novosellski “Trinia e Shenjtë” në qytetin Aprillci në Stara Pllanina.

Ai është i themeluar gjatë vitit 1830 si një manastir familjar. Gjatë kohës së Kryengritjes së Prillit gjatë vitit 1876 vendi i shenjtë bëhet qendër e Republikës së njohur Novosellska. Atëherë, në vazhdim të 9 ditëve, “Trinia e Shenjtë” kthehet në një fortesë të rebelëve, të cilët bënë një rezistencë kokëforte ushtarëve të shumtë turq. Pas shpartallimit të kryengritjes, bashkë me të gjithë qytetin Aprillci, manastiri është djegur deri në themel, kurse banorët e tij u masakruan nga trupat osmane. Sot, në paraklisin pas kishës ka një muze të vogël, ku ruhen eshtrat e të vvarëve.

Shikoni videon:

``

— bnr.bg